



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

# **Plani i Integruar i Ministrisë 2008**

Shkurt 2008

## Mesazhi i Ministrit



Të nderuar lexues,

Për të dytin vit rradhazi, Ministria e Financave paraqet përpara jush Planin e Integruar të Ministrisë, ku përfshihen sfidat dhe angazhimet e saj më të rëndësishme, për vitin në vazhdim.

Një nga sfidat e mëdha, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, është “Zhvillimi i shpejtë, i balancuar dhe i qendrueshëm ekonomik, social dhe njerëzor i vendit”. Për arritjen e këtij synimi, Qeveria është angazhuar: “Të reformojë thellësisht planifikimin e financave publike, duke zbatuar Sistemin e Planifikimit të Integruar, i cili do të sigurojë harmonizimin e hartimit të buxhetit vjetor me kuadrin e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim dhe me Procesin e Stabilizim Asocimit në BE, si dhe me politika dhe strategji të tjera prioritare sektoriale”.

Viti 2008 do të shënojë një hap të rëndësishëm pozitiv në zhvillimin ekonomik e financiar të vendit. Duke ruajtur stabilitetin makroekonomik e financiar, si një faktor themelor në zhvillimin e sektorit privat, do të synohet që për vitin 2008 ritmi i rritjes ekonomike të jetë përtej kufirit të programuar prej 6%, të garantohet objektivi i inflacionit prej  $3\% \pm 1$ , të zbutet papunësia në kufijtë e 13%, dhe të përmirësohet më tej bilanci tregtar dhe ai i pagesave të vendit.

Për realizimin e planeve të zhvillimit, Qeveria ka nevojë për rritje të qëndrueshme të të ardhurave. Objektivat kryesorë që do të ndjekë politika e taksave për vitet në vijim janë rritja e bazës së taksueshme dhe përmirësimi i klimës së investimeve. Kjo fushë e financave publike përballon sfida të vështira për shkak të informalitetit në ekonominë shqiptare, përdorimit të gjerë të cash-it, mungesës së kulturës së pagimit të detyrimeve ndaj shtetit, besimit në institucionet publike dhe perceptimit të korrupsionit në këto institucione. Politikat Buxhetore do të synojnë vazhdimin e financimit me përparësi të sektorëve prioritarë si: arsimit, shëndetësia, mbrojtja dhe infrastruktura, që kanë një ndikim të rëndësishëm në nivelin dhe qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike, si dhe do të synojnë një lidhje më të fortë të alokimeve buxhetore me strategjitë sektoriale. Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, me qëllim rritjen e vazhdueshme të efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të tyre, si dhe ndërtimi i një sistemi bashkëkohor të menaxhimit financiar, do të jetë një nga objektivat më të rëndësishëm në këtë fushë.

Në këtë kuadër, politikat fiskale dhe administrimi i financave publike do të vazhdojnë të orientohen drejt vendosjes së parimeve dhe standarteve të legjislacionit evropian dhe rritjes së kapaciteteve në Ministrinë e Financave për zbatimin e tyre.

Duke ju falenderuar,

Ridvan Bode  
Ministër i Financave



## Pasqyra e lëndës

|         |  |    |
|---------|--|----|
| 1       | Misioni i Ministrisë .....                       | 5  |
| 2       | Dokumenta strategjike të Ministrisë .....        | 6  |
| 3       | Programet buxhetore të Ministrisë .....          | 8  |
| 4       | Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....  | 10 |
| 5       | Plani i Monitorimit i Ministrisë .....           | 15 |
| Aneks 1 | Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....            | 16 |
| Aneks 2 | Rezultate që lidhen me Integrimin European ..... | 18 |
| Aneks 3 | Investimet publike .....                         | 21 |
| Aneks 4 | Projekte të ndihmës së huaj.....                 | 22 |

## 1 Misioni i Ministrisë

Misioni i Ministrisë së Financave është të sigurojë mobilizimin dhe përdorimin me efikasitet, efektivitet, transparencë dhe integritet, të burimeve financiare të vendit, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të politikave të Qeverisë.

Kjo përfshin politikat në fushën e të ardhurave, programimin e buxhetit dhe zbatimin e tij, menaxhimin e borxhit, menaxhimin dhe kontrollin e shpenzimeve dhe menaxhimin e pasurisë publike. Ministria e Financave ka gjithashtu një rol të përgjithshëm këshillues në interes të Qeverisë, për promovimin e efikasitetit, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik, dhe në ato institucione financiare në të cilat Qeveria merr pjesë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e të gjitha taksave kombëtare, si dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Misioni i saj është mbledhja e të ardhurave tatimore, duke i ofruar taksapaguesve një shërbim cilësor dhe duke i ndihmuar ata të shlyejnë detyrimet ndaj shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka si mision të saj sigurinë e tregjeve dhe të popullatës (mbrojtja e kufijve kombëtare, mbrojtja e konsumatorëve, mbrojtja e mjedisit) nëpërmjet mbikqyrjes efikente të doganave dhe bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit, mbledhjes të të ardhurave nga taksat që administrohen nga doganat, dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e biznesit nëpërmjet aplikimit të metodave moderne të punës dhe krijimit të “Doganave elektronike”.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka si mision të tij ristrukturimin e sistemit publik të pensioneve. Synimi i tij është përfitimi i pensioneve më të mira për ata që paguajnë kontribute dhe lidhja më e mirë e përfitimeve me kontributet e paguara. Kjo bëhet duke nxitur njëkohësisht futjen në skemën kontributive të atyre që nuk paguajnë dhe duke krijuar një ambient të favorshëm për zhvillimin e tregut financiar të sigurimeve, pa çenuar të drejtat e fituara të pensionistëve dhe të punonjësve që kanë derdhur kontribute në skemën aktuale.

## 2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

### Strategjia sektoriale e financave publike 2007-2013

Në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar në Shqipëri, Këshilli i Ministrave, miratoi Strategjinë e Financave Publike 2007-2013 e cila mbulon:

- Politikën makroekonomike dhe atë fiskale, administrimin e buxhetit të shtetit, administrimin financiar dhe kontrollin
- Administrimin e të ardhurave nga taksat (në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve)
- Administrimin e të ardhurave nga doganat (në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave)

Strategjia sektoriale e financave publike, si çdo strategji tjetër, pasqyron: (i) Programin e Qeverisë, (ii) Integrimin European dhe Euro-Atlantik, (iii) Investimet publike dhe (iv) Asistencën e huaj

Strategjia e financave bazohet në katër shtylla kryesore: Rritjen e cilësisë së shpenzimeve; Zgjerimin e bazës së taksueshme dhe përputhjen e politikës së taksave me prioritetet kombëtare; Modernizimin e menaxhimit të borxhit publik; Rritjen e performancës dhe besueshmërisë të administratave tatimore dhe doganore.

### Strategjia ndërsektoriale e sigurimeve shoqërore

Gjatë vitit 2007 është punuar nga grupi i punës i ngritur në Këshillin e Ministrave, për reformën e sistemit të pensioneve, për hartimin e Dokumentit të Opsioneve të Reformës së Sistemit të Pensioneve. Në 15 nëntor 2007, ky dokument u diskutua në Komitetin e Planifikimit Strategjik, ku u vendos krijimi i një grupi teknik pune me anëtarë të të gjitha forcave politike për të hartuar planin e reformës duke filluar me reformimin e sistemit aktual deri në përgatitjen e kushteve për futjen e skemës së pensioneve të detyrueshme private. Gjatë vitit 2008 grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave Nr. 32, datë 14.02.2008 do të punojë për të finalizuar dokumentin e strategjisë së reformimit të sistemit të pensioneve në Republikën e Shqipërisë.

### Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- **Forcimi i kapaciteteve administrative në Ministrinë e Financave; përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Financave.**
- **Përafrimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin dhe standardet europiane, sipas fushave; afrimi i kushteve të punës me standartet e BE. Krijimi i një sistemi modern të pagesave dhe kontabilitetit brenda vitit 2009.**
- Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike (të programuar në nivelet mbi 6% deri në 2013) dhe mbajtjes nën kontroll të inflacionit (intervali 2-4% i synuar).
- Ndërtimi i një sistemi efektiv të programimit buxhetor, mbi bazë programesh për të gjitha institucionet buxhetore deri në vitin 2012.
- Menaxhimi i procesit të zbatimit të buxhetit të shtetit sipas standarteve ndërkombëtare deri në vitin 2012.

- Sigurimi i huamarrjes publike nëpërmjet një menaxhimi aktiv me bazë koston dhe riskun.
- Harmonizimi i politikave të pagesave të programit “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” me programin e Qeverisë dhe respektimi rigoroz i kërkesave që rrjedhin nga marrëveshjet dhe aktet e vendimet gjyqësore.
- Sigurimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me transparencë, efikasitet, ekonomi dhe efektivitet dhe implementimi e zhvillimi i një sistemi modern e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar publik -KBFP me një shërbim të pavarur të funksionimit të auditimit të brendshëm dhe me një drejtim dhe organizim qëndror dhe të harmonizuar në Ministrinë e Financave, për të siguruar zbatimin e standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombetare në këtë fushë.
- Krijimi i një institucioni eficient, brenda një harku kohor trevjeçar, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike me qëllim administrimin korrekt të fondeve. Afrimi i kushteve të punës të institucionit të sigurimeve shoqërore me standartet e BE, vendosja e personave të siguruar në qendër të kujdesit të politikave sociale.
- Implementimi me sukses i të gjitha standarteve ndërkombëtare të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit brenda vitit 2014.
- Hartimi dhe zhvillimi i një plani kombëtar të strategjive të luftës, parandaluese dhe ndërgjegjësuese të publikut mbi luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit brenda vitit 2014.
- Të asistohen dhe nxiten tatim paguesit në mënyrë që të paguajnë detyrimet e duhura në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar që të ardhurat tatimore dhe taksat shkojnë për llogari të buxhetit të shtetit, nëpërmjet ofrimit të një sistemi deklarimi dhe pagese eficiente.
- Të maksimizohet mbledhja e të ardhurave nga tatimet, taksat dhe kontributet e sigurimeve, brenda kuadrit të legjislacionit tatimor.
- Të minimizohet kostoja e mbledhjes së të ardhurave, pa rrezikuar efektivitetin e mbledhjes së tyre si dhe sasinë dhe cilësinë e shërbimeve që duhet t’u ofrohen tatimpaguesve.
- Të modernizohen operacionet e deklarimit, pagesës dhe auditimit të tatimeve dhe taksave nëpërmjet zgjerimit ekstensiv dhe intensiv të procedurave të informatizuara.
- Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të tatimpaguesve kontribues, reduktimi sinjifikativ i elementëve të evazionit dhe mospagesës së detyrimeve tatimore.
- Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut.
- Garantimi i aplikimit të drejtë të legjislacionit doganor që siguron konkurrencë të lirë në treg.
- Forcimi i mirëadministrimit të regjimeve doganore ekonomike me impakt ekonomik dhe social.
- Realizimin me sukses të misionit fiskal të sistemit doganor me anë të rritjes së performancës në mbledhjen e të ardhurave.

## **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

### **3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Ministrisë së Financave, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese për implementimin e politikave, që bëjnë të mundur përmbushjen e standarteve të vendosura nga BE, si dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Ministrisë.

### **3.2 MENAXHIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE**

Politika e këtij programi konsiston në kryerjen e analizave dhe parashikimeve makro-fiskale, përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve publike me qëllim rritjen e vazhdueshme të efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të tyre, si dhe përmirësimin e menaxhimit të borxhit publik.

### **3.3 EKZEKUTIMI I PAGESAVE TË NDRYSHME**

Politika e këtij programi konsiston në përmbushjen e detyrimeve që lindin nga marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare, mbështetjen e institucioneve financiare sipas legjislacionit në fuqi, ekzekutimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, kryerjen e pagesave të menjëhershme në favor të funksionarëve të lartë të administratës publike si dhe përafrimin e legjislacionit në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitaleve dhe shërbimeve.

### **3.4 MENAXHIMI I TË ARDHURAVE TATIMORE**

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e tatimeve, me qëllim përafrimin me parimet e *acquis communautaire*. Zhvillimi i një sistemi taksash që mbështet formulimin e politikave fiskale të drejta dhe nxitëse për zhvillimin ekonomik dhe mbështetjen e biznesit. Shpërndarja e barrës fiskale në mënyrë të barabartë dhe pa deformime. Adoptimi i një sistemi të rrafshët fiskal me norma të ulta taksash, si dhe menaxhimi i pajtueshmërisë fiskale. Zgjerimi i bazës së taksueshme dhe përputhja e politikës tatimore me prioritetet kombëtare.

### **3.5 MENAXHIMI I TË ARDHURAVE DOGANORE**

Politika e këtij programi konsiston në rritjen e rolit mbrojtës të doganës shqiptare, forcimin e rolit ekonomik të doganës, rritjen e performancës në mbledhjen e të ardhurave, bashkëpunimi me doganat homologe, përafrimin me legjislacionin e BE-së.

### **3.6 AUDITIMI I BRENDSHËM DHE KONTROLLI I FINANCAVE PUBLIKE**

Politika e këtij programi konsiston në krijimin e një ambienti të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të sektorit publik në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE. Në qendër të sistemit të PIFC qëndrojnë përgjegjshmëria menaxheriale dhe auditimi i brendshëm i decentralizuar e funksionalisht i pavarur. Kontrolli i brendshëm publik fokusohet në transparencë në termat e vendosjes së linjave të qarta të përgjegjësisë dhe në terma të

harmonizimit të metodologjisë dhe standarteve. Natyra e tij parandaluese ka si qëllim të sigurojë vendosjen e sistemeve të nevojshme për parandalimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit.

### **3.7 MENAXHIMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Politika e këtij programi konsiston në: Përmirësimin e funksionit të ISSH nëpërmjet shtimit të kapaciteteve drejtuese; Informatizimit të sistemit në përgjithësi dhe të arkivave në veçanti; Përmirësimin të infrastrukturës me qëllim mbulimin e popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore atje dhe në atë kohë kur lind kjo e drejtë; Përmirësimin e funksionit të ISSH në drejtim të administrimit të transfertave të Buxhetit të Shtetit për programet sociale të qeverisë. Ky program parashikon dhënien e përfitimeve atje ku lindin dhe në jo më shumë se 45 ditë, krijimin e bazës së të dhënave për çdo përfitues dhe kontribues dhe përmirësimin e punës në lidhje me modernizimin e arkivave.

### **3.8 LUFTA KUNDËR TRANSAKSIONEVE FINANCIARE JO-LIGJORE**

Politika e këtij programi konsiston në thellimin dhe zgjerimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përafrimin dhe përshtatjen e legjislacionit shqiptar përkatës me standartet ndërkombëtare të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet: hartimit dhe plotësimit të tij me një ligj të ri dhe akte nënligjore korresponduese; rritjes së efikasitetit nëpërmjet ndërtimit të një platforme të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe zhvillimit të performancës së burimeve njerëzore si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës :

- Organizimi i Trajnimeve për stafin e ri në masën 50% dhe për stafin ekzistues në masën 25%
- Përmirësimi i shërbimeve për punonjësit e Ministrisë dhe marrëdhëniet me të tretët.
- Menaxhimi eficient i burimeve financiare.
- Rritja e cilësisë së auditimit për sigurimin e menaxhimit dhe përdorimin me efektivitet të fondeve publike.
- Mirëmbajtja e sistemit kompjuterik të thesarit

Produktet kryesore që synohet të ofrohen:

- 20 pajisje zyrash të blera
- 80 trajnime të kryera për stafin e ministrisë
- 40 auditime të kryera
- Mbështetje për licensat e oracle-it
- Shërbime zyre dhe të përgjithshme

### 4.2 MENAXHIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE

Objektivat e politikës:

- Përgatitja e kuadrit makro-fiskal 2008-2011 si element bazë për përgatitjen e Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2009-2011 dhe Buxhetit Vjetor 2009.
- Përmirësimi i programimit buxhetor, përgatitja e PBA 2009-2011, buxhetit vjetor 2009, udhëzimeve për zbatimin e buxhetit, udhëzimeve të procedurave mbi aplikimet e reja të sistemit të thesarit, mbi bazën e parimeve të ligjit të ri organik të buxhetit.
- Përgatitja në kohë dhe cilësi e raporteve financiare të konsoliduara të zbatimit të buxhetit 2008, duke zbatuar pjesërisht standartet e GFS 2001.
- Përmirësimi i raportit të borxhit publik në raport me GDP-në duke ndjekur strategjinë e borxhit dhe objektivat e saj.

Produktet që do të ofrohen:

- 2 analiza të kuadrit makro-fiskal të kryera;
- PBA 2009-2011 dhe Buxheti vjetor 2009 i hartuar;
- 12 raporte financiare të konsoliduara;
- Borxhi i shtetit i manaxhuar efektivisht.

### 4.3 EKZEKUTIMI I PAGESAVE TË NDRYSHME

Objektivat e politikës:

- Shlyerja e detyrimeve në kohë për pjesëmarrjet në kapital ndaj institucioneve financiare dhe parashikimi i detyrimeve të reja për periudhën afatmesme.
- Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në kohë sa më të shkurtër pasi merr formën e prerë në përputhje me fondet buxhetore në dispozicion.
- Mbështetje financiare për institucione financiare të veçanta sipas kuadrit ligjor në fuqi (Bursa e Tiranës).

Produktet kryesore që synohet të ofrohen:

- Pagesa të menjëhershme për funksionarët e lartë të administratës
- 120 pagesa të vendimeve gjyqësore
- Pagesa si kontribut i antaresimit në institucione nderkombetare

### 4.4 MENAXHIMI I TË ARDHURAVE TATIMORE

Objektivat e politikës:

- Realizimi sasior i objektivit në fushën e mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe detyrimeve kontributive në nivelin e programuar buxhetor.
- Realizimi i objektivave sasiorë të vendosur lidhur me numrin e kontribuesve, nëpërmjet evidentimit dhe eliminimit të punës së zezë.
- Implementimi i përmirësimeve dhe ndryshimeve ligjore të ndërmarra nga Qeveria gjatë vitit 2007 dhe në vazhdim. Matja e efekteve të tyre në të ardhurat tatimore.
- Realizimi i projektit të ristrukturimit të administratës tatimore nëpërmjet reduktimit të Degëve të Tatimeve joeficiente dhe krijimit të Drejtorive Rajonale me funksione të plota brenda vitit.
- Përmirësimi cilësor i shërbimit ndaj tatimpaguesve, nëpërmjet krijimit të qendrave efektive të shërbimit në Drejtoritë Rajonale dhe vecanërisht në Tiranë.
- Futja në sistemin e integruar tatimor i të gjitha Drejtorive Rajonale të krijuara. Përpunimi i informatizuar i deklaratave për tatimpaguesit e gjithë vendit.
- Konsolidimi i Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me synim arkëtimin prej saj të 56-58 përqind të të ardhurave totale.
- Rritja e numrit të tatimpaguesve me 5 mijë tatimpagues të rinj.

Produktet që do të ofrohen:

- Regjistrimi i 410 mijë kontribuesve për kontributet e sigurimeve shoqërore në fund të muajit maj 2008.
- Mundësi shkarkimi në internet të deklaratave, mbi 90 përqind e tatimpaguesve të regjistruar në shkallë vendi deri në fund të vitit 2008.
- Trajnimi i 1000 punonjësve të administratës tatimore
- Godina të rikonstruara në Degët Rajonale : Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë.
- Produkte të sistemeve të informacionit: shtim Hardware dhe sisteme të dhënash të paisjeve fiskale.

- Paisje teknike ndërlidhjeje për funksionet e zbatimit, inteligjencës dhe investigimit

#### **4.5 MENAXHIMI I TË ARDHURAVE DOGANORE**

Objektivat e politikës:

- Modernizimi dhe lehtësimi i procedurave doganore
- Forcimi dhe kontrolli i mbrojtjes së tregut
- Ulja e kontrabandës dhe evazionit fiskal
- Kontrolli i trafiqeve ilegale dhe drogës

Produktet që do të ofrohen:

- 350,000 deklarata zhdoganimi
- 400 autorizime dhe licenca
- 150 punonjës të trajnuar
- Godinë e Drejtorisë së Përgjithshme e Deganave e rikonstruktuar
- Pajisje zyre dhe elektronike.

#### **4.6 AUDITIMI I BRENDSHËM DHE KONTROLLI I FINANCAVE PUBLIKE**

Objektivat e politikës:

Udhëheqja metodologjike, sigurimi i zbatimit të standarteve dhe zhvillimi i kuadrit organizativ për auditimin e brendshëm.

Rritja e cilësisë së auditimit të brendshëm për sigurimin e ligjshmërisë, efektivitetit, eficensës së fondeve publike

Produktet që do të ofrohen:

- 30 Auditime të kryera në Institucione Publike.
- 7 akte ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe përditësuara
- 242 punonjës të trajnuar në vijimësi
- 240 punonjës të trajnuar për titullin “Auditues i brendshëm”.

#### **4.7 MENAXHIMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Objektivat e politikës:

- Përmirësimi i administrimit të fondit të sigurimeve shoqërore dhe i shërbimit ndaj përfituesve (pensionistë apo përfitues afatshkurtër); kordinimi i forcimit të kontrollit të brendshëm të përdorimit të fondeve me dhënie e të drejtave në afatet e përcaktuara me ligj nëpërmjet krijimit të bazës së të dhënave për pensionet dhe fillimit të punës për bazën e të dhënave të kontributeve.
- Administrimi i fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për programe të veçanta të qeverisë për të kompensuar pakësimin e të ardhurave të përfituesve, me kompensime për energjinë elektrike, bukën, etj., si edhe për të ardhura shtesë për kategori të veçanta përfituesish si pensione të posaçme, invalidë pune e lufte, veteranë etj.

- Administrimi i fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për përfitime suplementare për punonjësit e shtetit, për ushtarakët e Ministrisë së Brendshme, për policinë e shtetit, për minatorët, për statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake.
- Administrimi i fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për përfitime suplementare, për ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes, për pilotët fluturues në pension dhe ushtarakët e nëndetseve në pension.

Produktet kryesore që synohet të ofrohen:

- Transferta të kryera në buxhetet familjare për paaftësinë e përkohshme
- 10,220 transferta në buxhetet familjare për barrëindjen
- 528,000 transferta në buxhetet familjare për pensionet
- Transferta në buxhetet familjare për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale
- 528,000 transferta në buxhetet familjare për kompensim energjie
- 370 transferta në buxhetet familjare për pensione të posacme shtetërore
- 18,265 transferta në buxhetet familjare për veteranët
- 5,900 transferta në buxhetet familjare për invalidët e punës
- 1,023 transferta në buxhetet familjare për sigurimin shtetëror suplementar
- 3,235 transferta në buxhetet familjare për sigurimin suplementar të ushtarakëve të MR dhe SHISH-it
- 4700 transferta në buxhetet familjare për punonjësit e nëntokës
- 1100 transferta në buxhetet familjare për statusin "Dëshmor i Atdheut"
- 882 transferta në buxhetet familjare për punonjësit e industrisë ushtarake
- 430 transferta në buxhetet familjare për policinë e shtetit
- 18,332 transferta në buxhetet familjare për sigurimin suplementar të ushtarakëve të MM
- 239 transferta në buxhetet familjare për sigurimin suplementar të pilotëve
- 125 transferta në buxhetet familjare për sigurimin suplementar të ushtarakëve të nëndetseve në pension.

#### **4.8 LUFTA KUNDËR TRANSAKSIONEVE FINANCIARE JO-LIGJORE**

Objektivat e politikës:

- Përshtatja e legjislacionit shqiptar mbi Pastrimin e Parave/Financimin e Terrorizmit me standartet ndërkombëtare të luftës kundër Pastrimit të Parave/Financimin e Terrorizmit; rritja e numrit të raporteve (Raporte të Transaksioneve të Vlerave dhe Raporte të Aktivitetit të Dyshimtë) të marra, deri në sasinë 60.000 në vit brenda vitit 2008; rritja e numrit të inspektimeve deri në 200 brenda vitit 2008.
- Dizajnimi i një platforme IT të plotë dhe eficiente për të ndihmuar në thithjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit financiar; përpunimi eficient i informacionit financiar të marrë nëpërmjet Raporteve të Transaksioneve të Vlerave e Raporteve të Aktivitetit të Dyshimtë me qëllim hartimin dhe përpilimin e dosjeve të plota për tu referuar në Prokurorinë e Përgjithshme për ndjekje penale.

Produktet që do të ofrohen:

- 60,000 raportime te transaksioneve mbi limitet ligjore.

**Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, million Lek**

| Programet  | Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore<br>600, 601 | Mallra dhe shërbime<br>602 | Subveconet<br>603 | Të tjera transferta korrente<br>604, 605 | Transferta për buxhetet familiare dhe individët<br>606 | Shpenzime kapitale<br>230, 231 | Total         |
|--|---|----------------------------|-------------------|--|--|--------------------------------|---------------|
| Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi                | 82.8  | 75                         | 0                 | 0  | 0  | 25                             | 182.8         |
| Menaxhimi i Shpenzimeve Publike                        | 248.5   | 136                        | 0                 | 0  | 0  | 3                              | 387.5         |
| Ekzekutimi i Pagesave të ndryshme                      | 0   | 0                          | 0                 | 100                                      | 120  | 0                              | 220           |
| Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore                      | 1288  | 381                        | 0                 | 1  | 0  | 80                             | 1750          |
| Menaxhimi i të Ardhurave Doganore                      | 968.8   | 315                        | 0                 | 10                                       | 0  | 970.9                          | 2264.7        |
| Lufta kundër Transaksioneve Jo-Ligjore                 | 30  | 12                         | 0                 | 0,25                                     | 0  | 2                              | 44.25         |
| Menaxhim i Sigurimeve Shoqërore                        | 0   | 0                          | 0                 | 1429                                     | 0  | 0                              | 1429          |
| Auditimi i Brendshëm dhe Kontrolli i Financave Publike | 26.7  | 27                         | 0                 | 0  | 0  | 0                              | 53.7          |
| <b>Total</b>   | <b>2644.8</b>   | <b>946</b>                 | <b>0</b>          | <b>1540.3</b>                            | <b>120</b>   | <b>1080.9</b>                  | <b>6331.9</b> |

## 5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008 janë:

| Treguesit   | Njësia | Sasia  |
|---|--------|--------|
| Buxheti 2009 dhe PBA 2009-2011 të përgatitur dhe të miratuar      | Nr     | 2      |
| Analiza e kuadrit makro-fiskal e kryer;                           | Nr     | 2      |
| Trajnime për stafin e ministrisë                                  | Nr     | 80     |
| Raporte financiare të konsoliduara                                | Nr     | 12     |
| Pagesa të vendimeve gjyqësore                                     | Nr     | 120    |
| Futja në skemën e pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore | Nr     | 410000 |
| Deklarata zhdoganimi  | Nr     | 350000 |
| Auditime të kryera në institucione publike                        | Nr     | 30     |
| Transferta në buxhetet familjare për pensionet                    | Nr     | 528000 |
| Raportime të transaksioneve mbi limitet ligjore                   | Nr     | 60000  |

## Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektligji i buxhetit të vitit 2009
- Projektvendim “Për miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2009-2011
- Projektvendim “Për numrin e punonjësve për vitin 2009”
- Projektvendim “Për shpenzimet e udhëtimit për jashtë shtetit”
- Projektvendim “Për rishikimin e vendimit në zbatim të ligjit për pensionet suplementare”
- Projektligj “Për parandalimin e krimit të organizuar (Në ndryshim të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004)
- Projektligj “Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” sipas DPPP
- Projektvendim “Mbi organizimin, kompetencat dhe funksionimin e AAPSK”
- Projektvendim “Mbi kriteret e vlerësimit, mënyrat dhe procedurat për dhënien në përdorim si dhe tjetërsim të aseteve të sekuestruara/konfiskuara
- Projektvendim “Mbi përdorimin dhe destinacionin e aseteve të konfiskuara”
- Projektligji i buxhetit faktik të vitit 2007
- Projektvendim dhe P/Ligji për privatizimin e INSIG
- Projektvendim dhe P/Ligji për privatizimin e UBA-s
- Projektvendim për Financimet e Huaja dhe procedurat e lëvrimet/raportimit të tyre
- Projektligji për Profesionet e lira
- Projektvendim “Për privatizimin e aksioneve të zotëruara nga shteti për shoqëritë anonime
- Projektvendim për privatizimin e pjesës së kapitalit në shoqëritë me kapital të përbashkët
- Projektligji “Për procedurat tatimore”
- Hartimi dhe miratimi i VKM “Manuali i ri për Procedurat e Auditimit të Brendshëm
- Nënshkrimi i një Memorandumi të ri MoU për Bashkëpunim Ndërinstitucional për parandalimin e pastrimit të parave në përputhje me ndryshimet e reja ligjore
- Projektligji për taksat vendore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
- Projektligji për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
- Projektligji “Për buxhetin e sigurimeve shoqërore për vitin 2008” (Pjesë e ligjit për buxhetin e shtetit)
- Projektligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”
- Projektvendim “Për ndryshime në VKM 167 datë 29.03.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”

- Projektvendim “Për rritjen e pensioneve”
- Projektvendim “Për caktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual për llogaritjen fillestare të pensionit”
- Projektvendim “Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve dhe pensioneve familjare të pilotëve që kanë humbur jetën në krye të detyrës”
- Projektvendim “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr.161 datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.
- Projektligj “Për Tatimin mbi të Ardhurat ”dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
- Projektligj “Për Akcizat”dhe aktet ligjore në zbatim të tij
- Projektvendim “Për një ndryshim në VKM nr. 205, datë 13.04.1999, të KM, për miratimin e dispozitave të kodit Doganor, të ndryshuar (për strukturën organike të Administratës doganore Shqiptare)
- Projektvendim “Për masën e shperblimit të anëtareve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm”
- Projektvendim “Për kriteret e ngritjes së njësive të auditimit të brendshëm në subjektet publike”
- Projektvendim “Për ngritjen dhe zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik” në kuadër të rishikimit të letër politikave për KBFP.

## Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

- Hartim i planit vjetor të investimeve (DPD)
- Hartim i planit vjetor të trajnimit të personelit doganor, përcaktim i tematikave më sensitive
- Implementimi i planit vjetor të investimeve
- Implementimi i planit vjetor të trajnimeve
- Rishikimi dhe përditësimi i PKZMSA si dhe thellimi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së acquis në kuadër të përafrimit të legjislacionit
- Shtrirja e Programit ASYCUDA ++ në të gjithë vendin
- Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i të gjithë aktivitetit të import-eksportit, në kuadër të luftës kundër trafikut të paligjshëm
- Ndalimi i diskriminimit fiskal për produktet e BE-së, shfuqizimi dhe mosvendosja e masave ose praktikave të reja fiskale të brendshme që krijon direkt ose në mënyrë të tërthortë diskriminimin midis produkteve të BE-së dhe atyre vendase
- Përfundimi i Manualit të Burimeve Njerëzore (DPT)
- Dokumentimi dhe përmirësimi i procedurave të punës së Policisë Tatimore
- Dokumentimi dhe përmirësimi i procedurave të kontrollit të brendshëm dhe investigimit të brendshëm
- Përmirësimi i kushteve akomoduese në Degën e Tatimeve Tiranë;
- Përmirësimi dhe vlerësimi i projektit për ngritjen e Qendrës së përhershme të Trajnimit Tatimor;
- Adaptimi i procedurave për regjistrimin unik të tatimpaguesve të biznesit të vogël;
- Azhurnimi i Manualeve Procedurale të regjistrimit, masave shtrënguese dhe akcizës.
- Ngritja e njesise qendrore të harmonizimit për strukturat e kontrollit të menaxhimit financiar, në kuadër të projektit PIFC-II, i cili pritet të fillojë së shpejti
- Përmirësimi i kushteve akomoduese në degën e tatimeve Tiranë
- Përfundimi dhe vlerësimi i projektit për ngritjen e Qendrës së përhershme të trajnimit tatimor
- Adoptimi i procedurave për regjistrimin unik të tatimpaguesve të biznesit të vogël
- Azhurnimi i manualeve procedurale të regjistrimit, masave shtrënguese dhe akcizës
- Projektligj i ri “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”(AMF)
- Rishikimi i udhëzimit të Ministrisë të Financave “Për format dhe procedurat e identifikimit dhe raportimit të organeve që licencojnë personat fizikë dhe juridikë në funksion të parandalimit të pastrimit të parave”
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit të ri “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”
- Organizimi i një konference rajonale për Bashkëpunimin Rajonal në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftës kundër Financimit të Terrorizmit

- Trajnimi i shoqërive të sigurimeve dhe / ose risigurimeve mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit
- Përgatitja e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit - IFRS
- Trajnimi i bankave të nivelit të dytë mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit
- Ligji i ri “Për obligacionet e shoqërive dhe të pushtetit vendor” (AMF)
- Projekt-ligj “Ndryshim i Kodit Doganor - Regjimet e përpunimit aktiv dhe pasiv”
- Projekt-ligj “Ndryshim i Kodit Doganor - Tranziti”
- Projekt-ligj “Ndryshim i Kodit Doganor - Shkeljet doganore”
- Projekt-ligj “Ndryshim i Kodit Doganor - Procedurat e thjeshtuara”
- Projekt-VKM “Për zbatimin e ligjit nr.7703 ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’” (ISSH)
- Projekt-VKM “Për rritjen e përfitimeve” (ISSH)
- Projekt-ligj “Për procedurat tatimore”
- Hartimi i një Strategjie gjithëpërfshirëse për mbledhjen e taksave dhe kontrollin
- Amendimi i ligjit për TVSH lidhur me përjashtimet për taksën e importit
- Udhëzim i Ministrit të Financave “Për Tatimin mbi të ardhurat”
- Projektligj “Për tatimin mbi të ardhurat - Zgjerimi i sistemit integral të deklarimit dhe pagimit të tatimit mbi të ardhurat personale”
- Udhëzim i Ministrit të Financave “Për akcizat”
- Projektligj “Për TVSH - Zgjerimi i bazës së tatim paguesve të TVSH nëpërmjet uljes së kufirit të regjistrimit për TVSH”
- Udhëzim i Ministrit të Financave “Për procedurat tatimore”
- Udhëzim i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”
- Projektligj “Për tatimin mbi të ardhurat”
- Projektligj “Për TVSH - Paraqitja e një tarife të reduktuar të TVSH”
- Udhëzim i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”
- Projektligj “Për akcizat”
- Udhëzim i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”
- Projekt VKM “Ndryshim i dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”
- Nënshkrimi i një Memorandumi të ri për Bashkëpunim Ndërinstitucional për parandalimin e pastrimit të parave në përputhje me ndryshimet e reja ligjore
- Projektligji i ri “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve” (AMF)
- Miratimi i Buxhetit Vjetor 2009
- Projekt VKM “Dispozitat zbatuese të KD”
- VKM Dispozitat Zbatuese të KD “Informacioni detyrues i origjinës”
- VKM Dispozitat Zbatuese të KD “Masat e Aut. Dod. në mbrojtje të pronësisë intelektuale”

- Hartimi dhe miratimi i VKM “Manuali i ri për Procedurat e Auditimit të Brendshëm”
- Trajnimi stafit të Kontrollit të Brendshëm
- Projekt VKM “Ndryshim i dispozitave zbatuese të Kodit Doganor - Procedurat e thjeshtuara”
- Implementimi i CWC për armët kimike
- Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për hartimin e strategjisë në fushën e luftës kundër pastrimit të parave
- Projekt ligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9267 datë 29.07.2004 ‘Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime’ (AMF)

## Aneks 3 Investimet publike

### Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

|   |          |
|---|----------|
|   | 000/lekë |
| Blerje pajisje kompjuterike, fotokopje, etj         | 8,000    |
| Rikonstruksion i godinës së Ministrisë së Financës. | 14,000   |
| Blerje Pajisje dhe orendi zyre                      | 3,000    |

### Menaxhimi i Shpenzimeve Publike

|   |          |
|---|----------|
|   | 000/lekë |
| Rikonstruksion i zyrave të degëve të thesarit | 350      |
| Blerje pajisje për zyrat e degëve të thesarit | 2,650    |

### Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore

|   |          |
|---|----------|
|   | 000/lekë |
| PAGESA për të drëjtë LIÇENCE (Orakulli) | 3,000    |
| Rikonstruksion i godinave në rrethe     | 77,000   |

### Menaxhimi i të Ardhurave Doganore

|  |          |
|--|----------|
|  | 000/lekë |
| Rikonstruksioni i Godinës së Drejtorisë    | 32,400   |
| Blerje dhe instalim skanera për konteniere | 375,000  |
| Blerje pajisje zyre dhe elektronike        | 3,500    |

### Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore

|                |          |
|----------------|----------|
|                | 000/lekë |
| Blerje pajisje | 2,000    |

## Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

| Projekti                                | Donatori          | Fusha e politikës   | Shuma totale, Mln Euro | Kohëzgjatja |
|---|-------------------|---|------------------------|-------------|
| Kompleksi doganor Qafë Bote             | Bashkimi Evropian | Nxitja e një bashkëpunimi më të frytshëm midis dy vendeve | 0.9                    | 2007-2008   |
| Kompleksi doganor Muriqan               | Bashkimi Evropian | Nxitja e një bashkëpunimi më të frytshëm midis dy vendeve | 1.5                    | 2007-2008   |
| Ndertimi i 10 pikave të kalimit kufitar | Bashkimi Evropian | Nxitja e një bashkëpunimi më të frytshëm midis dy vendeve | 1.4                    | 2007-2009   |
| Skaner për konteniere                   | Qeveria Kineze    | Rritja e eficiencës së shërbimit doganor                  | 2.4                    | 2008        |

## Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

- Realizimi i 30 misioneve audituese, mbikqyrëse dhe investiguese në kuadër të luftës kundër korrupsionit
- Nënshkrimi më 22 Maj 2008 i Memorandumit të bashkëpunimit “Për krijimin e Njesisë së Përbashkët Hetimore për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit” midis Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Sherbimit Informativ të Shtetit me qëllim rritjen e cilësisë së hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale, rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional në kuadër të veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit. DPPP përfaqësohet në këtë njësi me një ndërlidhës të posaçëm në Ekipin e Shtatë që funksionon si “Ekipi për kërkimin dhe vlerësimin e informacionit për rregjistrimin e procedimeve me Iniciative”
- Fuqizimi i strukturave të antikorrupsionit në DPT;
- Ngritja e strukturave të inteligjencës dhe investigimit tatimor në Selinë Qëndrore dhe Drejtoritë Rajonale;
- Zbatimi i procedurave të përmirësuara të kontrollit tatimor, të parashikuara në Ligjin e ri të procedurave tatimore;
- Zbatimi i procedurave lidhur me të drejtat e tatimpaguesve, të parashikuara në Ligjin e ri të procedurave tatimore;
- Zbatimi i procedurave standarte ligjore në rekrutimin e punonjësve të rinj të administratës tatimore;
- Shqyrtimi në komisionin e disiplinës i çdo rasti të dyshuar apo të provuar korrupsioni të punonjësve të administratës tatimore;
- Përmirësimi i monitorimit të punës së Degëve rajonale nga strukturat përgjegjëse në DPT.